

**24.** Gratë dhe vajzat në Turqi, ku shpesh burrat që rrahin, përdhunojnë, apo edhe vrasin gratë nuk ar-restohen. Shumë gra nuk raportojnë abuzime në polici për shkak të frikës se mund të abuzohen më tej ose të turpërimin të familjes e tyre.

**25.** Gratë e reja në Azinë Qëndrore që kanë duruar praktikën e tmerrshme të vjedhjes së nuses. Tradita lejon që një burrë të rrëmbejë vajzën që dëshiron të martohet. Vjedhja e nuses është zyrtarisht e paligjshme, por akoma ndodh në Kirgistan.

**26.** Gratë dhe fëmijët në vendet e shkatërruara nga lufta si Siria dhe Jemeni, të cilët nuk marrin ushqimin, kujdesin shëndetësor ose arsimin e duhur.

**27.** Gratë arabe, që Perëndia të derdhë Shpirtin e tij mbi to, që të mund të shohin ëndrra dhe vizione të Jezusit dhe të mund shpëtoheshin dhe të fuqizoheshin për të qenë dëshmitaret e tij.

**28.** Gratë që të dëgjojnë këshilla të dobishme mjekësore dhe ushqyese në programet “Shpresë për ty” që do t’i ndihmojnë ato të kujdesen më mirë për familjet e tyre. Shumë gra në rajonin e CAMENA –s nuk kanë qenë kurrë në shkollë.

**29.** Gratë që kanë vuajtur shumë sepse varësia ndaj alkoolit apo drogës ka shkatërruar jetën e të dashurëve të tyre dhe ka shkaktuar probleme të mëdha financiare.

**30.** Gratë e reja që largohen nga shtëpitë e tyre duke shpresuar që të marrin vende më të mira pune në vende të tjera. Shumë prej tyre kanë rënë në kurth nga krimi i organizuar dhe janë shitur në skllavëri seksuale.

**31.** Gratë që kanë marrë dhuratën e shpëtimit dhe shpresën e re për të ardhmen pas dëgjimit të programeve Shpresë për ty në gjuhët e tyre të zemrës. “Ti do të më tregosh shtegun e jetës; ka shumë gëzim në praninë tënde; në të djathtë tënde ka kënaqësi në përjetësi.” (Ps 16:11).

CAMENA është emërtimi stenografik i përdorur nga TWR për rajonin që përfshin Azinë Qëndrore, Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut. Në këtë rajon të botës, të bëhesh i krishterë ndonjëherë është ilegale. Kjo mund të përfshijë arrestimin, marrjen në pyetje ose burgimin. Shumë prej tyre janë larguar nga vendet e punës, ju është mohuar arsimimi ose u është ndaluar të përdorin ujin lokal dhe shërbimet e tjera të komunitetit. Ndryshimi i fesë mund të rezultojë në refuzimin, kërcënimin, sulmimin deri në vrasjen nga anëtarët e familjes. Si rezultat, shumë të krishterë përpiqen ta mbanjnë besimin e tyre të fshehtë, madje edhe nga një bashkëshort ose prind.

Të krishterët në rajonin e CAMENA-s nuk e dinë se kujt duhet t’i besojnë. Ata shpesh janë të izoluar, pa takime të kishës për nxitje, mësim ose përforsim të përbashkët. Sidoqoftë, këta besimtarë e vlerësojnë shpresën që kanë gjetur në Jezusin dhe duan dëshpërimisht të rriten në kuptimin e tyre për Perëndinë. Programet e radios janë shumë të rëndësishme për t’u dhënë njohuri nga Fjala e Perëndisë që i forcon ata përmes rrethanave të tyre sfiduese.

Shumë grave në rajonin e CAMENA-s u është mësuar se ato kanë pak vlerë. Askush nuk kujdeset për idetë, mendimet apo emocionet e tyre. Pritet që ato të punojnë shumë duke u shërbyer të tjerëve në familjet e tyre. Femrat janë gjithashtu të poshtëruara dhe abuzuara në punë, në shkollë dhe në komunitetet e tyre. Pak gra guxojnë të raportojnë abuzim në polici. Shpesh, përdhunimi i fajësohet gruas dhe jo burrit. Jeta e tyre është e mjerueshme.

Nëpërmjet programeve radiofonike të TWR Shpresë për ty në privatësinë e shtëpive të tyre, gratë e izoluar dhe të dhunuara gjejnë zëra të kujdesshëm, këshilla të dobishme dhe pranim. Ata fillojnë të kuptojnë se Perëndia ka fuqinë t’i ngrejë ato mbi rrethanat e tyre të tmerrshme dhe të rivendosë dinjitetin e tyre nëpërmjet hirit dhe dashurisë së Jezusit.

## *Të lutemi për gratë në Azinë Qëndrore, Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut*



Dëgjoni kalendarin e lutjes online në  
[twr-albania.com](http://twr-albania.com)

**Dëgjoni programin “Shprese per ty” në:**

Radio 7: 97,7 FM: të shtunën ora 8:30

Radio Emanuel: 95,7 FM të shtunë ora 9:00

Radio Logos: 94,2 FM të shtunë/ të dielë ora 9:00 dhe

17:00



## Të lutemi për...

1. Forcën dhe fuqinë e Perëndisë që të rrethojë gratë e krishtera të persektuara për besimin e tyre në Jezus Krishtin. “Edhe sikur të ecja në luginën e hijes së vdekjes, nuk do të kisha frikë nga asnjë e keqe, sepse ti je me mua; shkopi yt dhe thupra jote janë ato që më japin zemër” (Psalmi 23: 4).

2. Siguri, shëndet dhe vajosjen e Perëndisë tek ata persona që prodhojnë programet e Shpresë për ty në arabisht, farsi, rusishten e Azisë qendrore, kabilisht, në gjuhën Kazake, Kirgize, Kurde-Sorani, Taxhikistaneze, Turqisht, Turkmene dhe Uzbeke.

3. Gratë që nuk kanë njohuri për dashurinë dhe faljen e Perëndisë që të dëgjojnë për shpëtimin e Perëndisë nëpërmjet Jezusit. Mësimet ateiste të komunizmit kanë verbuar shumë të vërtetën e Perëndisë. Fetë dhe mitet popullore rreth krishtërit bënë që shumë njerëz të përfshihen në grackën e gënjeshtërave të Satanit. “Por kur Izraeli të kthehet te Zoti, veli do të hiqet. Sepse Zoti është Fryma, dhe atje ku është Fryma e Zotit, atje është liria. Dhe ne të gjithë, duke soditur fytyrëzbuluar lavdinë e Zotit si në pasqyrë, transformohemi në të njëjtën shëmbëllim nga lavdia në lavdi, posi prej Frymës së Zotit.” (2 Korintasve 3: 16-18).

4. Gratë në rajonin e CAMENA-s që të përjetojnë paqen dhe lirinë jo vetëm në kombet, komunitetet dhe shtëpitë e tyre, por edhe në zemrat e tyre nëpërmjet një marrëdhënieje me Jezusin. “do ta njihni të vërtetën dhe e vërteta do t’ju bëjë të lirë. ... Pra, nëse Biri do t’ju bëjë të lirë, do të jeni me të vërtetë të lirë” (Gjoni 8:32, 36).

5. Gratë që të dëgjojnë se Perëndia i do ato dhe se ato janë të çmuara për të edhe nëse janë poshtëruar nga etërit, vëllezërit, burrat dhe djemtë e tyre. “Bijtë e saj ngrihen dhe e shpallin fatlume; edhe burri i saj e lëvdon duke thënë: “Shumë bija kanë bërë gjëra të mëdha, por ti i kalon të gjitha ato Hiri është i rremë dhe bukuria është e kotë, por gruaja që ka frikë nga Zoti është ajo që do të lëvdohet.” (Fjalët e Urta 31: 28-30).

6. Nënata e krishtera në Azinë Qendrore (Kazakistan, Kirgistan, Taxhikistan, Turkmenistan, Uzbekistan) të cilat kanë nevojë për mençuri se si të trajtojnë

praktikat tradicionale gjatë ngjarjeve familjare si dasmat dhe funeralet.

7. Gratë që jetojnë në fshatra të largëta në kushte shumë të vështira. Shumë prej tyre kanë pak shpresë për të ardhmen e tyre. Lutuni që ato të dëgjojnë programet e radios dhe të gjejnë paqe dhe shpresë në Jezusin.

8. Besimtarët që përjetojnë përndjekje të rënda në disa prej vendeve të CAMENA-s dhe nuk kanë të drejtë të mblidhen për adhurim. Kjo i bën shërbesat e organizuara të grave pothuajse të pamundura.

9. Të krishterët që udhëtojnë në vende të tjera vetëm për të takuar besimtarë të tjerë, për të studiuar Fjalën e Perëndisë, për të qenë në gjendje të këndojnë këngët e adhurimit së bashku, për t’u pagëzuar ose për të pasur një martesë të krishterë.

10. Nënata e divorcuara që kanë humbur kontaktin me fëmijët e tyre.

11. Gratë arabe që kanë humbur burrat, djemtë ose bijat e tyre si rezultat i luftës. Lutuni që ato të gjejnë forcë dhe shpresë përmes një takimi me Zotin Jezus.

12. Dorën e Zotit që të jetë me gratë e krishtera irakiane dhe familjet e tyre që duhet të largoheshin nga vendi i tyre për shkak të persekutimit nga ekstremistët. Lutuni që të krishterët do t’i ndihmojnë ato të përshtaten në vendet e tyre të reja.

13. Për ata 25.000 të krishterët që janë kthyer në lagjen Hamdaniya të Irakut, pasi terroristët i dogjën shtëpitë dhe kishat e tyre, duke i detyruar që 55.000 të iknin. Lutuni për gratë që po luftojnë për të rindërtuar shtëpitë dhe familjet e tyre.

14. Shumë besimtarë të rinj në Iran që po arrestohen kur zyrtarët konfiskojnë librat, CD-të, laptopët dhe marrësit satelitorë. Gjithashtu disa kërcënohen nga fqinjët dhe anëtarët e familjes.

15. Për të vërtetën në lidhje me dashurinë e Perëndisë dhe dhuratën e tij të shpëtimit për të arritur gratë e CAMENA-s që jetojnë larg shtëpisë. Shumë janë të zhgënjyera me besimin e paraardhësve të tyre dhe po kërkojnë përgjigje për sfidat e jetës.

16. Ata persona që hyjnë në faqen arabe të Facebook Laki Raja (Shpresë për ty) dhe bëjnë pyetje rreth besimit dhe kuptimit të jetës. Numri i ndjekësve të kësaj faqeje ka tejkaluar 132,000, dhe ka një arritje të madhe me informacion për burrat dhe gratë që ndërveprojnë përmes rrjeteve sociale.

17. Nënata që të kenë më shumë mundësi për të studiuar Fjalën e Perëndisë me qëllim që të rrisin fëmijët e tyre të jenë të fortë në besim. “do t’ua mësosh bijve tuaj, duke u folur për to kur rri ulur në shtëpinë tënde, kur ecnën rrugës, kur rri shtrirë dhe kur çohesh” (Ligji i Përtërirë 11:19).

18. Gratë që jetojnë në errësirën kulturore, emocionale dhe shpirtërore dhe kanë nevojë të madhe për dashuri të pakushtëzuar. Shumë nuk kanë përjetuar kurrë dashuri ose askush nuk u ka thënë se janë të çmuara.

19. Gratë e TWR Shpresë për ty që ofrojnë ushqim, ilace, strehim, miqësi dhe shpresë në Jezusin tekta shkojnë tek njerëzit e vetmuar dhe të frikësuar, si dhe të sëmurët, invalidët, të veajat, refugjatët ose nënata. “se, në mes të shumë sprovave pikëllimi, mbushullia e gëzimit të tyre dhe varfëria e tyre e thellë e treguan në pasuritë e dorëgjërësinë e tyre. Sepse unë dëshmoj se ata kanë dhënë me dëshirë dhe sipas mundësisë së tyre, madje edhe përtej mundësisë së tyre,” (2 Korintasve 8: 2-3).

20. Udhëheqësit e Kishës për të dhënë mësim biblik që trajton shqetësimet familjare siç janë abuzimi fizik, rritja e fëmijëve, financat dhe trajtimi i të tjerëve me dinjitet.

21. Të krishterë në Algjeri të cilët nuk janë më në gjendje të takohen së bashku, sepse kishat e tyre janë mbyllur. Disa janë ndjekur penalisht, gjobitur dhe kërcënuar.

22. Udhëheqësit botërorë që t’i mbajnë qeveritë përgjegjëse, duke siguruar që liria fetare të ruhet në përputhje me të drejtën ndërkombëtare.

23. Gratë e krishtera në Algjeri, të cilat dëshirojnë të jenë dëshmitare të fuqisë së Perëndisë dhe dashurisë së tij nëpërmjet mënyrës se si i trajtojnë burrat e tyre që ende nuk janë besimtarë.